



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 58 Prot.

Tiranë, më 02/06/2025

V E N D I M

Nr. 1, datë 02/06/2025

P Ë R

**HAPJEN E PROCESIT TË KANDIDIMIT PËR DISA VENDE VAKANTE PËR
ANËTARË TË KOMISIONEVE TË ZGJEDHJEVE NË FAKULTETE (KZF)**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024 – 2028, në Universitetin Politeknik të Tiranës”, neni 6 dhe neni 7, urdhrin nr. 24, datë 28.05.2025 të Rektorit “Për shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor dhe përcaktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve,

VENDOSI:

1. Hapjen e procesit të kandidimit për disa vende vakante për anëtarë të Komisioneve të Zgjedhjeve në Fakultete (KZF).
2. Kandidatët për anëtarë të KZF – ve vetëkandidohen pranë sekretarisë së KIZ.
3. Formulari i vetëkandidimit për anëtarë dhe sekretarë të KZF-ve plotësohet pranë sekretarisë së KIZ.
4. Kandidatët përfaqësues të studentëve, duhet të paraqesin vërtetimin që ndjekin studimet në Universitetin Politeknik të Tiranës.
5. Numri i vendeve vakante për çdo njësi kryesore është si më poshtë:
 - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit 1 anëtar (përfaqësues i personelit akademik);
 - Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike 1 anëtar (përfaqësues i studentëve);

6. Afati i vetëkandidimit të kandidatëve për anëtarë të KZF – ve, fillon ditën e martë datë 03.06.2025 dhe përfundon ditën e mërkurë, datë 04.06.2025, ora 14:00.

7. Kandidimi për anëtarë dhe sekretarë të KZF-ve, kryhet pranë Sekretarisë së KIZ (Zyra e Sektorit Juridik në Rektorat nr. 116).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Edmond PERGEGA

Kryetar

Alfred PJETRI

Anëtar

Albina BASHOLLI

Anëtar

Anjeza DULAJ (GJINI)

Anëtar

Nelda KOTE

Anëtar

Irida GJOKA (MARKJA)

Anëtar

Klajdi QOSHI

Anëtar

Pietro BELBA

Anëtar

Lidia HYSA

Anëtar

